



Lajmet e Fundit: Belsh – Finalizohet operacioni policor i koduar “Deshiran”



21/09/2021

DVP Korçë – Vihen në pranga 3 shtetas, për vepra të ndryshme penale

DVP Korçë

Vihen në pranga 3 shtetas.

Posedonte armë zjarri dhe lëndë narkotike në banesë, vihet në pranga 40-vjeçari.

Sekuestrohet 1 armë zjarri tip automatik me një krëhër me 25 fishekë dhe lëndë e dyshuar narkotike Cannabis Sativa.

Arrestohen edhe 2 shtetas të tjerë që drejtonin mjetin në mënyrë të parregullt.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Korçë, në vijim të punës për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si rezultat i kontroleve të shtuara për rritjen e parametrave të sigurisë, në bazë të informacioneve të siguruara në rrugë policore se një shtetas posedonte armë dhe lëndë narkotike, kanë organizuar shërbimet dhe kanë ushtruar kontroll në banesën e të dyshuarit, në lagjen nr. 6, të qytetit të Korçës.

Forcat e Policisë, gjatë kontrollit në banesën e shtetasit O. E., kanë gjetur 1 armë zjarri tip automatik me një krëhër me 25 fishekë, si edhe një sasi me lëndë të dyshuar narkotike Cannabis Sativa, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Në përfundim të veprimeve specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Korçë, bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit O. E., 40 vjeç.

Specialistët për Hetimin e Krimeve në Komisariatin e Policisë Pogradec, bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit S. A., 32 vjeç, banues në fshatin Buçimas, Pogradec, pasi në rrugën “Rinia” në Pogradec, ky shtetas u kap duke drejtuar pa leje drejtimi mjetin motor tip “Lonçin” pa targë dhe gjatë kontrollit fizik iu gjet në xhep një sasi e vogël me lëndë të dyshuar narkotike Cannabis Sativa, e cila iu sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Gjithashtu specialistët e Sektorit për Policinë Rrugore në DVP Korçë, bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit A. H., 30 vjeç, banues në Pogradec, pasi në Pogradec, ky shtetas u kap duke drejtuar në gjendje të dehur, mjetin tip “BMW”.

Materialet në ngarkim të tyre i kaluan Prokurorive së Rretheve Gjyqësore Korçë e Pogradec për veprime të mëtejshme.

Share

Share

Share

in Share

Email

◀ Fier – Arrestohen në flagrancë 2 shtetas, procedohet penalisht 1 tjetër

Elbasan – Nuk iu bind urdhrit të punonjësit të Policisë për të ndaluar dhe në tentativë e sipër për t’u larguar aksidentoi punonjësin e Policisë, vihet në pranga 31-vjeçari ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Shërbimi Për Qështjet e Brendshme dhe Ankesat](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)